

PËR CAKTIMIN E PROCEDURËS PËR VEPRIM
NË RASTET PËR MBROJTJE NGA
DISKRIMINIMI NË BAZË TË ORIENTIMIT
SEKSUAL DHE IDENTITETIT GJINOR

PROTOKOLL

Botues H.E.R.A. – Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim, 2015

Protokollin për vërtetimin e procedurës për veprim në raste të mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor ishte përpiluar në kuadër të projektit Avancimi i sundimit të drejtës për LGBT qytetarët në Maqedoni, të realizuar nga HERA, Koalicioni Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara dhe Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, të mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Maqedoni. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi e miratoi këtë protokoll në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2015.

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi e miratoi këtë protokoll në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2015.

Redaktor i parë: Dragana Karovska Cemerska

Autorë: Natasa Boskova, Dusko Minovski

Dizajni: Damjan Momirovski

Shtypi: Propoint Skopje

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.724.037:305(497.7)(094.2)

BOSKOVA, Natasa

Protokoll per caktimin e procedures per veprim ne rastet per mbrojtje nga diskriminimi ne baze te orientimit seksual dhe identitetit gjinor / [avtorin Natasa Boskova i Dusko Minovski]. - Skopje: Hera, 2015. - 20 стр.; 21 см

ISBN 978-608-4598-44-2

1. Minovski, Dusko [автор]

а) Заштита од дискриминација - Полов идентитет - Маргинализирани групи - Македонија - Протоколи

COBISS.MK-ID99176714

PËRMBAJTJA

PROTOKOLL **04**

ANEKS I PROTOKOLLIT **07**

I. Definicione dhe terme të cilat mund të përdoren në veprim në rastet e diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor **07**

II. Praktika kornizë ndërkombëtare për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identiteti gjinor **09**

III. Organizata të cilat punojnë në çështje për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit seksual janë: **11**

FORMULARI I PARASHTRESË **14**

Në bazë të nenit 24 alineja 1 pika 12 nga Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi e miratuan Protokollin për veprim në rastet për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

PROTOKOLL

PËR CAKTIMIN E PROCEDURËS PËR VEPRIM NË RASTET PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË BAZË TË ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETIT GJINOR

1. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi (në testin mëtejshëm: Komisioni), në pajtim me nenin 3 nga LPMD vepron në rastet për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
2. Komisioni pranon parashtesa me shkrim të cilat përmbajnë të dhëna personale të parashtruesit dhe mandatorit, nëse parashtesa është dorëzuar përmes mandatorit.
3. Komisioni ka përgatitur formë ku parashtruesit mund të parashtrojnë parashtesë për mbrojtje nga diskriminimi, por Komisioni do të pranojë dhe shqyrtojë parashtesa të cilat nuk janë dorëzuar në formën e përcaktuar. Formulari gjendet në shtojcë të këtij protokoll. (Formulari përmban edhe orientim seksual si bazë për mbrojtje nga diskriminimi).
4. Parashtesa me shkrim përmban informata për një dhe më shumë baza për mbrojtje nga diskriminimi për shkak të cilave parashtruesit parashtrues, fusha në të cilën është kryer diskriminimi, kryesi potencial i diskriminimit, si dhe përshkrimi i ngjarjes me kohë, vendi dhe mënyra e kryerjes së diskriminimit.
5. Parashtesa mund të parashtrohet personalisht dhe gojarisht në procesverbal në ambientet e Komisionit, përmes telefonit gjatë orarit të punës të Komisionit, çdo ditë prej të hënës deri të premten nga ora 9-16. Komisioni ka postë elektronike zyrtare përmes të cilës pranon parashtesa për mbrojtje nga diskriminimi (contact@kzd.mk)
6. Të punësuarit në Komision, me kërkesë të viktimës e cila e parashtron parashtesën, personalisht de gojarisht në ambientet e Komisionit ose përmes telefonit, përpilojnë shënim zyrtar në bazë të cilës vepron më tutje Komisioni.
7. Për çdo parashtesë të pranuar Komisioni formon lëndë e cila shënohet me numër rendor dhe datën e pranimit të lëndës dhe të gjitha veprimet e ndërmarra në atë rast do ta mbajnë numrin e njëjtë.
8. Nëse parashtesa nuk i përmban të dhënat e nevojshme që të mund të vepohet sipas të njëjtës, Komisioni përmes lajmërimit do të kërkojë plotësim të parashtesës nga ana e parashtruesit në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit. Lajmërimi përmban drejtime të qarta se në cilën pjesë nevojitet qartësim ose plotësim për parashtesën.

9. Pas pranimit të parashtrësës së plotë, rasti i jepet ndonjë anëtar i Komisionit (i cili ka përgatitur adekuate profesionale për fushë të caktuar ose bazën sipas të cilës kërkohet mbrojtje nga diskriminimi).

10. Komisioni, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i parashtrësës, do të parashtrorë lajmërim me shkrim deri te diskriminuesi potencial, me të cilin do ta informojë se kundër atij është ngritur procedurë për mbrojtje nga diskriminimi dhe do ta obligojë në pajtim me nenin 31 dhe 32 nga LPMD që në afat prej 30 ditëve t'i dorëzojë të dhënat për diskriminimin dhe të lejojë kontroll dokumentet, me qëllim të vërtetimit të drejt të gjendjes faktike për vërtetimin e diskriminimit.

11. Lajmërimi deri te diskriminuesi potencial do të përmbajë kërkesë për informatat e dhe dokumentet e duhura, të cilat i nevojiten Komisionit për kontroll, që të mund të veprojnë në rastin konkret. Pyetjet deri te diskriminuesi potencial duhet të jenë të qarta dhe të pa dyshimta, ndërsa me qëllim të vërtetimit të drejt të gjendjes faktike.

12. Me lajmërimin, diskriminuesi potencial do të paralajmërohet se nëse nuk e respekton afatin për dorëzimin e informatave dhe dokumenteve të nevojshme, Komisioni do të parashtrorë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtës, për çka i kërcënohet gjobë në pajtim me LPMD.

13. Komisioni, e informon me shkrim parashtruesin për pranimin dhe veprimin për procedurën e parashtruar dhe veprimet e ndërmarra me qëllim të caktimit të diskriminimit.

14. Komisioni, nëse ka nevojë për informata plotësuese, mund t'i drejtohet shoqatave të qytetarëve dhe ekspertëve të cilët punojnë në fushën (baza për mbrojtje nga diskriminimi), për të cilën ka të bëjë parashtrësja dhe të kërkojë informata plotësuese, sqarim për fakte të caktuara, të dhëna statistikore dhe dëshmi tjera të cilat mund të shërbejnë për vërtetimin e drejt të gjendjes faktike.

15. Komisioni mund t'i thërrasë palët në ambientet e veta për shkak të grumbullimit të informatave plotësuese dhe sqarim të fakteve të caktuara me rëndësi për procedurën.

16. Komisioni mund të dale në vendin e ngjarjes dhe përmes dokumenteve dhe informatave të kapshme te diskriminuesi potencial t'i grumbullojë dëshmitë e nevojshme për vërtetimin e drejt të gjendjes faktike.

17. Për çdo veprim të ndërmarrë Komisioni përgatit procesverbal, ku shënohet koha, vendi dhe llojet e veprimeve të ndërmarrë, si dhe personi përgjegjës që ka marrë pjesë në ndërmarrjen e veprimeve dhe personat tjerë që kanë qenë të inkuadruar.

18. Pasi që të grumbullohen të gjitha informatat e nevojshme, faktet dhe dëshmitë, anëtar i Komisionit, të cilit i është besuar rasti, do të përgatisë raport, i cili do t'i përmbajë të gjitha gjetjet e parashtruesit të parashtrësës, gjetjet e diskriminuesit potencial, faktet e propozuara de të nxjerra, mendimet dhe të dhënat e grumbulluara nga shoqatat dhe ekspertët, raportet ekzistuese, të dhënat statistikore relevante për lëndën.

19. Raporti shqyrtohet në mbledhje të Komisionit, ku shqyrtohet rasti dhe faktet individualisht de si tërësi. Pastaj, hidhet në votim propozimi, me të cilin duhet të vërtetohet jo/ekzistimi i diskriminimit; lloji i diskriminimit; baza mbi të cilën është vërtetuar diskriminimi; kundër kujt është vërtetuar diskriminimi nëse janë paraqitur më shumë diskriminues potencial; baza juridike për diskriminimin e vërtetuar dhe rekomandimet të cilat do të dalin nga rasti.

20. Komisioni mund të thirre ekspert/përfaqësues të shoqatës, që ka njohuri dhe përvojë në fushë të caktuar, që ta japë kontributin e vet në shqyrtimin e rasteve, lëndë e shqyrtimit gjatë mbledhjeve.

21. Anëtarët e Komisionit vendimin për mos/ekzistimin e diskriminimit e sjellin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

22. Anëtari i Komisionit i cili nuk pajtohet me vendimin e shumicës, mund të japë arsyetim me shkrim për vendimin e vet dhe ky mendim do të publikohet në ueb faqe.

23. Në bazë të rezultateve nga votimi, anëtari i Komisionit i cili drejtpërsëdrejti ka punuar në rast bashkë me bashkëpunëtorët profesional në Komision, në afat prej 15 ditëve ka përgatitur mendim me shkrim, ku do të përmbahet dispozita e vendimit për mos/ekzistimin e diskriminimit, arsyetimi për vendimin e miratuar me bazën juridike dhe rekomandimet drejt diskriminuesit për mënyrën e heqjes të diskriminimit.

24. Vendimi i Komisionit në mënyrë të obliguar përmban vërejtje deri te diskriminuesi, se e ka për obligim që në afat prej 30 ditëve ta mënjanojë diskriminimin nën frikën për ngritjen e iniciativës për vendosjen e procedurës para organit kompetent për vërtetimin e përgjegjësisë nga ana e Komisionit (neni 28 alineja 3 dhe neni 29 LPMD).

25. Vendimi me shkrim dorëzohet deri te parashtruesi dhe diskriminuesi potencial dhe publikohet në ueb faqen e Komisionit. Mendimet e miratuara për rastet në të cilat është vendosur për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual, vendoset në portfolio të veçantë në pjesën Mendime lidhur me parashtruesat e cila është shënuar me orientim seksual.

26. Komisioni mban të dhëna statistikore për numrin e parashtrësve të parashtruar në bazë të orientimit seksual dhe për ato raporton në raportin vjetor.

27. Aneksi me informata plotësuese dhe Formulari për parashtrimin e parashtrësve për mbrojtje nga diskriminimi janë pjesë përbërëse e këtij Protokolli.

ANEKS I PROTOKOLLIT

PËR VËRTETIMIN E PROCEDURËS PËR VEPRIM NË RASTET PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË BAZË TË ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETIT GJINOR

I. DEFINICIONE DHE TERME TË CILAT MUND TË PËRDOREN NË VEPRIM NË RASTET E DISKRIMINIMIT NË BAZË TË ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETIT GJINOR:

LGBTI - shkurtesë e cila përdoret për njerëzit lesbiane-gej-biseksual-trans gjinor dhe interseksual.

Orientimi seksual – aftësia e një personi për tërheqje të thellë emocionale, dashurie dhe seksuale, ndaj, si dhe për marrëdhënie intime dhe seksuale me individë të gjinisë tjetër, të gjinisë së njëjtë ose më shumë se një gjini.

Biseksualiteti – orientimi seksual që ka të bëjë me njerëzit të cilët tërhiqen seksualisht, shpirtërisht dhe në mënyrë afektive nga të dy gjinitë. Njerëzit e tillë quhen edhe biseksual.

Heteroseksualiteti – orientim seksual që ka të bëjë me ata të cilët tërhiqen në mënyrë seksuale, shpirtërore ose afektive nga persona nga gjini të ndryshme.

Homoseksualiteti – orientim seksual që ka të bëjë me ata njerëz tërheqja seksuale, shpirtërore, afektive e të cilëve kryesisht është e orientuar drejt personave nga gjinia e njëjtë. Zakonisht, meshkujt e tërhequr nga meshkuj të tjerë quhen gej, ndërsa femrat e tërhequra nga femrat tjera quhen lesbiane (edhe pse të njëjtit mund të përcaktohen/identifikohen si gej).

MSM - ('meshkujt që kanë seks me meshkuj' ose 'seks mes meshkujve') është term që përdoret kryesisht në shëndetësinë publike dhe ka të bëjë në cilin do mashkull, që ka marrëdhënie seksuale me mashkull tjetër pa dallim nëse kjo ndodh përkohësisht, rregullisht ose si shprehje e identitetit homoseksual. Termi përdoret që të përshkruhet tipi i aktivitetit seksual pa hyrë në definimin e identitetit të personit (orientim homoseksual dhe heteroseksual) dhe përdoret me qëllim të intervenimeve shëndetësore (veçanërisht parandalimi dhe trajtimi i HIV/SIDA, arsimimi dhe shërbimet) që të mund t'u ofrohen personave në bazë të përdorimit të tyre. Termi ekuivalent FSF (femra me femër) nuk ekziston në dokumentet publike, por përdoret në hulumtime.

Identiteti gjinor – ka të bëjë me ndjenjën personale dhe perceptimin personal të gjinisë, që mund por edhe nuk do të thotë të korrespondojë me gjininë me të cilën personaliteti e fiton gjatë lindjes. Këtu bien edhe ndjenja personale për trupin (që mund të nënkuptojë ndryshim të pamjes fizike ose funksioneve trupore me ndihmën e mjeteve mjekësore, kirurgjike dhe tjera, nëse ky ndryshim është me zgjedhje të lirë) si dhe shprehje tjera të gjinisë si veshja, të folurit dhe vijat e karakterit).

Njerëz trans gjinor (trans) – Term i përgjithshëm që ka të bëjë me njerëzit identiteti gjinor i të cilëve dhe/ose shprehja e gjinisë dallohet nga gjinia biologjike e fituar gjatë lindjes. Termi mund të përfshijë edhe njerëz trans seksual dhe interseksual, tranvestitë dhe njerëz me diversitete/variante tjera gjinore, por nuk kufizohet vetëm te ato.

Njerëz transseksual – individë të cilët identifikohen me gjini të ndryshme nga ajo që lidhet me gjininë biologjike të fituar me lindje. Personaliteti trans seksual mund të jetë mashkull në femër ose femër në mashkull. Po ashtu, njerëz të cilët janë të ekspozuar në terapi hormonale, ndërsa nuk kanë qëllim të kryejnë intervenim kirurgjik, vetveten e quajnë trans seksual. Femrat transseksuale, të cilët biologjikisht kanë lindur si meshkuj quhen meshkuj në femra (MTF-male-to-female). Meshkujt trans seksual gjinia biologjike e të cilëve është fituar me lindje janë femra, quhen femra në meshkuj (FTM – female-to-male). Njerëzit trans gjinor dhe trans seksual mund të identifikohen si heteroseksual, homoseksual (gej, lesbiane), biseksual, ose orientim tjetër seksual. Me fjalë tjetër, identiteti gjinor dhe orientimi seksual nuk varen njëra nga tjetra.

Personi interseksual – personalitet që ka lindur me gjenitale dhe organe riprodhuese të cilat nuk mund të definohen as si tipike mashkullore, as si tipike femërore. Pjesa më e madhe e personaliteteve interseksuale janë viktima të intervenimeve kirurgjike të panevojshme dhe terapive hormonale të kryera më shpesh pa pëlqimin e tyre. Në të kaluarën për njerëzit interseksual është përdorur termi hermafrodit, që edhe sot përdoret, por llogaritet si joadekuat dhe ofendues.

Homofobia – qëndrim, urrejtje, paragjykim dhe diskriminim i konstruar irracional ose shoqëror ndaj njerëzve me orientim homoseksual dhe biseksual dhe të gjithë ata për të cilët në përgjithësi supozohet se janë gej, lesbiane ose biseksual. Personat të cilët janë mjaft homofobik, homoseksualitetin e llogaritarin si të gabuar dhe të sëmure, ndërsa ndaj homoseksualëve ndjejnë urrejtje, neveri dhe jo rrallë dëshirë për vrasje. Aksione konkrete të dhunës mbi homoseksualitetin shpeshherë janë rezultat i homofobisë.

Transfobia – qëndrim, urrejtje, paragjykim dhe diskriminim i konstruar irracional ose shoqëror ndaj njerëzve trans gjinor. Personat të cilët janë shumë transfobik, trans gjininë e llogaritin për të gabuar dhe të sëmure, ndërsa ndaj njerëzve trans gjinor ndjejnë urrejtje, neveri dhe jo rrallë dëshirë për vrasje. Transfobia është qëndrim i cili del nga kuptimi stereotip dhe kulturor se gjinia është kategori natyrore dhe universale dhe se çdo dalje nga korniza mashkullore-femërore paraqet sëmundje dhe rrezik. Aksionet konkrete të dhunës, shpeshherë edhe vrasja, mbi njerëzit trans gjinor janë rezultat shumë i shpeshtë i transfobisë.

II. PRAKTIKA KORNIZË NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË BAZË TË ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETI GJINOR

1. Praktika ndërkombëtare për mbrojtje nga diskriminimi

A) Komiteti për të drejtat e njeriut pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Toonen vs. Australia

Komiteti për të drejtat e njeriut ka vendosur se ligji në Tasmani (Australi) me të cilin kriminalizohet lidhja vullnetare seksuale mes meshkujve të moshës madhore, e shkel të drejtën e privatësisë të garantuar me Paktin për të drejta qytetare dhe politike dhe paraqet diskriminim në bazë të orientimit seksual.

Young v. Australia (2000)

Xv. Columbia (2007)

Komiteti në dy raste ka vendosur se kufizimi i të drejtës së përdorimit të pensionit nga partneri i vdekur i gjinisë së njëjtë, e drejtë që në këtë rast ka qenë e garantuar vetëm për partnerët jashtë martesës të gjinisë së ndryshme, paraqet diskriminim në bazë të orientimit seksual. Në rastin e parë, orientimin seksual, Komiteti e komenton se është pjesë e “gjinisë” themelore, derisa në rastin e dytë nga viti 2007 e definon komentimin për orientimin seksual si “status tjetër”.

Irina Fedotova v Russia

Komiteti për të drejtat e njeriut në vitin 2012 ka vendosur se ekzistimi i ligjit, me të cilin sanksionohen njerëzit të cilët publikisht e shprehin homoseksualitetin paraqet diskriminim në bazë të orientimit seksual.

B) Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut

Baczkowski and others v. Poland ankesa nr. 1543/06

Alekseyev v. Russia Ankesat nr. 4916/07, 25924/08 и 14599/09

GENDERDOC-M v. Moldova (Ankesa nr. 9106/06)

Gjykata në të tre rastet ka përfunduar se kufizimi i realizimit të lirive të organizimit të tubimeve publike, ku promovohen të drejtat e LGBTI njerëzve, paraqet diskriminim në bazë të orientimit seksual.

Salgueiro Da Silva Mouta v Portugal 6p. 33290/96

Gjykata ka vërtetuar se gjykatat shtëpiake me vendimin me të cilin nuk iu është dhënë kujdestaria e babait, për shkak të orientimit të tij homoseksual është dallim që nuk është i pranueshëm në pajtim me Konventën dhe paraqet shkelje të jetës private dhe familjare, lidhur me ndalesën për diskriminimin nga neni 14 i KEDNJ.

E.B. vs. France ankesa nr. 43546/02

Në këtë rast gjykata ka vërtetuar se gruaja e cila është në lidhje stabile lesbiane me partneren, kërkesa e të cilës për birësim të fëmijës i është refuzuar, paraqet diskriminim në bazë të orientimit të saj seksual. Në të vërtetë, Gjykata vëren se gjykata administrative ka vendosur se edhe pse është bazuar në orientimin seksual të aplukuesit, nuk ka qenë bazë për miratimin e vendimit për lëndën dhe nuk është shqyrtuar nga aspekti armiqësor. Megjithatë, sipas mendimit të Gjykatës, është i rëndësishëm fakti se orientimi seksual shpesh është përmendur në arsyetimin e vendimit edhe për shkak të mënyrës se si janë shprehur mendime të caktuara, zbulon se homoseksualiteti i aplikueses ka qenë faktori vendimtar.

Karner v Austria ankesa nr. 40016/98

Karner kundër Austrisë, është rasti i parë i lidhur me të drejtat e partnerëve të gjinisë së njëjtë, që GJEDNJ është pajtuar ta shqyrtojë. Pas vdekjes së partnerit të gjinisë së njëjtë, qiradhënësi e ka filluar procedurën për ndërprerjen e qirasë së partnerit të gjallë. Gjykata themelore dhe regjionale në Vjenë, termi “bashkëshorti jetësor” nga marrëveshja për qira e ka komentuar në mënyrë që i njëjti i përfshinë edhe partnerët e gjinisë së njëjtë, të cilët një kohë të gjatë kanë jetuar bashkë. Por, Gjykata supreme nuk është pajtuar me komentimin e këtillë të gjykatave më të ulëta. Prandaj, Gjykata ka vërtetuar se Shteti nuk ka ofruar shkak bindës dhe të rëndësishëm që e arsyeton komentimin e ngushtë të pjesës nga Marrëveshja për qira, me të cilin e pengon partnerin e gjallë të çiftit të gjinisë së njëjtë që të thërritet në atë dispozitë dhe ka vërtetuar se është kryer diskriminim në bazë të orientimit seksual.

Vallianatos and others v. Greece ankesa nr. 29381/09 dhe 32684/09

Gjykata ka vërtetuar se përjashtimi i çifteve të gjinisë së njëjtë janë fushëveprimi i ligjit me të cilin mundësohet partneriteti qytetar vetëm për partnerët nga e njëjta gjini paraqet diskriminim në bazë të orientimit seksual.

X. v. Turkey ankesa nr. 24626/09

Gjykata mëndin se izolimi i të burgosurit në qeli me arsyetimin se kjo është për shkak të masave të sigurisë për mbrojtje të burgosurit nga lëndimi trupor është e papranueshme dhe për këtë shkak ai ka qenë viktimë e diskriminimit në bazë të orientimit të tij seksual.

III. ORGANIZATA TË CILAT PUNOJNË NË ÇËSHTJE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË BAZË TË ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETIT SEKSUAL JANË:

Koalicioni TË DREJTAT SEKSUALE DHE SHËNDETËSORE TË BASHKËSIVE TË MARGJINALIZUARA Shkup

Koalicioni DSSHBM punon në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të LGBTI njerëzve, përmes dokumentimit të rasteve të shkeljes së të drejtave të LGBTI njerëzve, sigurimi i ndihmës juridike pa pagesë dhe këshillimi në rast të diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe përfaqësimi para institucioneve kompetente. Koalicioni ofron ndihmë psiko-sociale dhe mbështetje të LGBTI njerëzve.

Kontakti:

Bul. Kliment Ohridski nr. 66-1/3, 1000 Shkup,

tel. 02/3214269

www.coalition.org.mk

LGBTI Qendra për mbështetje

Qendra punon me LGBTI bashkësinë përmes organizimit të grupeve për vetë ndihmë, organizimin e aktiviteteve sociale. Qendra ofron ndihmë juridike pa pagesë, monitorim, raportim, avokim dhe lobim me qëllim të përmirësimit të gjendjes me LGBTI njerëzit.

Kontakti:

rr. Naum Naumovski Borçe nr. 83, 1000 Shkup, tel. 02/3119073

www.lgbti.mk

H.E.R.A.- Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim

HERA siguron shërbime vullnetare dhe të besueshme për shëndetin seksual dhe riprodhues, duke përfshirë testimin për HIV dhe për infektimet tjera seksualisht të transmetueshme, si dhe ndihmë juridike dhe sociale.

Kontakti:

Ул. Дебарца бр. 56/4, 1000 Скопје

Тел. 02/3290395

www.hera.org.mk

EGAL – Shoqatë për barazi të gej dhe lesbianeve,

EGAL realizon aktivitete për shëndet seksual dhe kulturë të jetës në LGBT skenën e dukshme në Maqedoni. Organizata siguron shërbime vullnetare dhe të besueshme për shëndet seksual, duke përfshirë testim për HIV dhe infektimet tjera seksualisht të transmetueshme.

Kontakti:

rr. Franklin Ruzvelt, nr. 9/3, 1000 Shkup

tel. 02/3213 337

LGBT Junajted Tetovë

LGBT Junajted punon në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut, kryesisht të LGBTI njerëzve, sigurimin e qasjes së barabartë deri te mbrojtja shëndetësore dhe sigurimin e shërbimeve sociale dhe juridike.

Kontakti:

044/617 400

078/385 570

info@lgbtunited.org

lgbtunitedmacedonia@gmail.com

Fronti Subverziv

Fronti Subverziv është organizatë e cila punon në promovimin e qasjes kritike, krijuese, kuir dhe jo patriarkale ndaj gjinisë dhe seksualitetit përmes organizimit të aksioneve publike, edukative dhe institucionale dhe debate të cilat kanë për qëllim t'i ofrojnë individit hapësirë më të madhe për identifikim personal ose jo identifikim në raport me gjininë dhe seksualitetin.

Kontakti:

rr. Venjamin Maçukovski nr. 1A-1/13, 1000 Shkup

info@s-front.org

Aleanca Femërore

Aleanca Femërore punon në forcimin, promovimin dhe rritjen e dukshmërisë së LGBTI bashkësisë në shoqëri përmes punëtorive, seminareve, konferencave, tribunave publike, aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes, lobimi, fushatave mediatike dhe tjera. Për nevojën për të drejta të barabarta për LGBT njerëzit, Aleanca femërore angazhohet për ndryshime dhe përmirësimin e legjislativës vendore.

Kontakti:

rr.Volgogradska/5/42, 1000 Shkup

tel: 078/243 649

info@womensalliance.mk

Rrjeti për luftë kundër homofobisë dhe transfobisë

<http://www.facebook.com/lgbtimreza>

Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi

Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi ka për qëllim të zhvillojë avokim strategjik në rastet e diskriminimit përmes parashtrimit të lëndëve para Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi dhe para gjykatave të vendit dhe ato ndërkombëtare. Zhvillimi i praktikës vendore është nxitja përmes sigurimit të ndihmës juridike pa pagesë në raste strategjike të diskriminimit. Rrjeti ishte themeluar në dhjetor të vitit 2010 nga ana e organizatave që vijojnë: Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni; Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Huluntim (HERA); HOPS – Opsionet për Jetë të Shëndetshme; Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të femrës në Republikën e Maqedonisë (ESE); Organizata Rome për Afirmim Multikulturor ROMA S.O.S – Prilep; Koalicioni “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara” dhe Qendra republikane për mbështetje të personave me pengesa intelektuale – PORAKA.

PARASHTRESË

E RËNDËSISHME: Nga parashtresa të cilën na e dërguat, kopje do të dorëzohet deri te personi fizik/juridik, gjegjësisht organi kundër të cilit e parashtroni parashtresën.

TË DHËNA PERSONALE PËR PARASHTRUESIN

1. EMRI:

2. MBIEMRI:

3. TITULLI:

(nëse parashtuesi është person juridik)

4. ADRESA/SELIA:

5. GJINIA:

6. DATA E LINDJES:

7. TELEFONI:

E-MAIL:

8. PËRKATËSIA ETNIKE:

(e dhënë jo e obligueshme)

9. PARASHTRESËN A E PARASHTRONI NË EMËR TË NDONJË PERSONI TJETËR:

(përgjigjuni me PO ose JO)

10. NËSE PËRGJIGJA E PYETJES SË MËPARSHME ËSHTË POHUESE,
CEKNI NË EMËR TË KUJT E PARASHTRONI PARASHTRESËN:

11. A KENI PËLQIM NGA PERSONI NË EMËR TË KUJT E
DORËZONI PARASHTRESËN:

(përgjigjuni me Po ose Jo; nëse PO, të njëjtën dorëzoni)

**TË DHËNA PËR PERSONIN FIZIK/JURIDIK,
GJEGJËSISHT ORGANI KUNDËR TË CILIT E PARASHTRONI PARASHTRESËN**

1. NËSE PARASHTRESA KA TË BËJË ME PERSON/ORGAN JURIDIK:

TITULLI:

SELIA:

TELEFONI:

A JENI I PUNËSUAR NË ATË PERSON/ORGAN JURIDIK:

(përgjigjuni me PO ose JO)

2. NËSE PARASHTRESA KA TË BËJË ME PERSON FIZIK:

EMRI DHE MBIEMR:

ADRESA:

TELEFONI:

**PERSONI PËR TË CILIN POHONI SE JU KA
DISKRIMINUAR KËTË E KA BËRË NË VEND
PUNË/DUKE I KRYER OBLIGIMET E PUNËS:**

(përgjigjuni me PO ose JO)

**NËSE PËRGJIGJA PARAPRAKE ËSHTË POZITIVE,
PËRMENDNI KU ËSHTË I PUNËSUAR PERSONI:**

(emri i ndërmarrjes/institucionit/organizatës, adresa, telefoni, pozita/vendi i punës së personit adekuat)

E RËNDËSISHME: Nëse ka më shumë persona fizik dhe/ose juridik, gjegjësisht organe kundër të cilëve parashtroni parashtrësë, Ju lutemi për secilin prej tyre të plotësoni parashtrësë të veçantë.

BAZA/T PËR DISKRIMINIM

**RRUMBULLAKONI NJË OSE MË SHUMË BAZA PËR DISKRIMINIM,
NË BAZË TË CILIT MENDONI SE JENI DISKRIMINUAR.**

1. GJINIA	12. ARSIMIMI
2. RACA	13. PËRKATËSIA POLITIKE
3. NGJYRA E LËKURËS	14. STATUSI PERSONAL OSE SHOQËROR
4. SEKSI	15. PENGESA MENTALE DHE TRUPORE
5. PËRKATËSI NË GRUP TË MARGJINALIZUAR	16. MOSHA
6. PËRKATËSIA ETNIKE	17. GJENDJA FAMILJARE OSE BASHKËSHORTORE
7. GJUHA	18. STATUSI PRONOR
8. SHTETËSIA	19. GJENDJA SHËNDETËSORE
9. ORIGJINA SOCIALE	20. ORIENTIMI SEKSUAL DHE IDENTITETI GJINOR
10. RELIGJIONI OSE BINDJA FETARE	21. NDONJË BAZË TJETËR: (përmendni cila)
11. BINDJE TJERA	

FAKTET (përmendni faktet të cilat i parashtroni në shtojcë të parashtrësës)

1.

2.

3.

4.

5.

1. A KENI NGRITUR PROCEDURË GJYQËSORE

(përgjigjuni me PO ose JO)

2. NËSE KENI NGRITUR, PARA CILËS GJYKATË DHE KUR

(dorëzoni edhe fotokopje nga padia)

3. A I JENI DREJTUR EDHE NDONJË INSTITUCIONI TJETËR


(përgjigjuni me PO ose JO)

4. NËSE JENI DREJTUAR, DERI TE CILI DHE KUR

(dorëzoni edhe fotokopje nga korrespondenca)

VENDI DHE DATA

NËNSHKRIMI



X. E. P. A.



A Member Association of

IPPF
European Network

International
Planned Parenthood
Federation



Kingdom of the Netherlands

